# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-451797**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Berisha që iu shiti naftë serbëve në 1995, vesh të tijtë me emblemën e UÇK-së |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392220.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 10:19:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 10:11:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 17 shtator 2026, 10:10:00 UTC → 17 shtator 2026, 10:12:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6854b52d67c9b2b1f3b89664c297b894f3f4c5fd7fc7878160a7979c3fd8733a` |
| TEKSTI | `10cea44784be6f9b5c6e7a23d77faa1e7a562342be8fbfec9a44bad588f66171` |
| PAMJA | `d399c27a9de58e9e872734c44da21f27789a103e4da09c64fd1a0bc1eece55f0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c4f901cc8e45ce8fb4067e750e1683e897a51eb8ddb1b3e48f3aae8e89e04f83` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c4f901cc8e45ce8fb4067e750e1683e897a51eb8ddb1b3e48f3aae8e89e04f83`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Berisha që iu shiti naftë serbëve në 1995, vesh të tijtë me emblemën e UÇK-së

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 17.09.2026, 12:11

Share Share

Berisha që iu shiti naftë serbëve në 1995, vesh të tijtë me emblemën e UÇK-së

Pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, deputetë të Partisë Demokratike u shfaqën në Kuvend me simbolet e UÇK-së, duke e kthyer sallën e Parlamentit në skenë solidariteti politik me ish-drejtuesit e saj. Por kjo pamje ngre një kontrast të fortë me të kaluarën e forcës politike që sot përdor këto simbole si mesazh mbështetjeje për Kosovën dhe UÇK-në.

Sali Berisha, në vitet e luftës në Kosovë, ishte president i Shqipërisë dhe më pas një nga figurat kryesore të politikës shqiptare. Në atë periudhë, Shqipëria u përball me akuza dhe kritika ndërkombëtare për rrjedhjen e karburantit drejt Jugosllavisë së Millosheviçit, pavarësisht embargos së vendosur nga OKB-ja. Vetë Berisha ka deklaruar se qeveria shqiptare ishte kundër embargos, duke argumentuar se ajo dëmtonte shqiptarët e Kosovës, ndërsa një raportim i New York Times i vitit 1995 fliste për sasi të mëdha karburanti që kalonin nga Shqipëria drejt Jugosllavisë dhe për shqetësimet e monitoruesve ndërkombëtarë.

Kështu, pamja e deputetëve të PD-së me emblemën e UÇK-së sot përballet me një pyetje të drejtpërdrejtë politike: a mjafton të mbash simbolin e UÇK-së në Parlament, kur e kaluara e drejtimit politik të kësaj force është shoqëruar me polemika të forta për marrëdhënien e Shqipërisë me regjimin e Milloshevicit? Për kritikët, kjo është një kontradiktë e fortë mes simbolikës së sotme dhe historisë politike të djeshme, duke e bërë shfaqjen e emblemave të UÇK-së të duket si një gjest i vonuar dhe politikisht oportunist.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

## Më të fundit

Dërgo materialin tënd këtu ›

Puno me ne! Marketing Politika e privatësisë Rreth Nesh Kushtet e përdorimit Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.